



Independent
Project
Accountability
Mechanism

Raporti i Tretë i Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit

Hekurudha Shqiptare
Projekti i BERZH-it numër 48466
Rasti 2023/02

Mars 2025

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin (IPAM) është mekanizmi i llogaridhënies i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). IPAM-i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet që individët ose organizatat ngrenë lidhur me Projektet e financuara nga Banka, për të cilat mendohet se kanë shkaktuar, ose kanë të ngjarë të shkaktojnë dëme. Qëllimi i Mekanizmit është të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve sociale, mjedisore dhe të dhënies së informacionit me palët e interesit të projektit; të përcaktojë nëse Banka ka vepruar në pajtueshmëri me Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale ose dispozitat specifike për projektin të Politikës së Aksesit në Informacion; si dhe, kur është e mundur, të trajtojë çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar çdo papajtueshmëri nga ana e Bankës në të ardhmen. Për informacione të mëtejshme rreth IPAM-it, na kontaktoni ose vizitoni www.ebrd.com/project-finance/ipam.html

Informacioni i kontaktit

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Five Bank Street
Londër E14 4BG

Telefon: +44 (0)20 7338 6000
Email: ipam@ebrd.com

Si të paraqisni ankesë në IPAM

Shqetësimet lidhur me performancën mjedisore dhe sociale të një Projekti të BERZH-it mund të paraqiten nëpërmjet email-it, postës ose formularit online në adresën:

☐ <https://www.ebrd.com/project-finance/ipam.html>

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
1. SFONDI.....	6
1.1. Kërkesa	6
1.2. Projekti	6
2. NISMA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT	6
3. MONITORIMI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT	7
3.1. Veprimtaritë e Monitorimit.....	7
3.2. Statusi i zbatimit të Marrëveshjes	8
4. PËRFUNDIMI.....	9

Përveçse kur përcaktohet ndryshe, termat me shkronjë të madhe në këtë raport janë të njëjtë me ata të përcaktuar në Politikën e Llogaridhënies për Projektin 2019.

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Forma e gjatë
Bordi	Bordi Drejtues i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Rasti	shqyrtimi i një Kërkese sipas Politikës së Llogaridhënies për Projektin pas regjistrimit
CAO	Drejtori i Përgjithshëm i Llogaridhënies i BERZH-it, dhe kreu i IPAM-it
Regjistri i Rasteve	Regjistri i Rasteve krijuar në përputhje me Seksionin III, Pikën 3.1 të Politikës së Llogaridhënies për Projektin, që mund të gjendet në faqen e internetit të IPAM-it
Përputhshmëria	funksion i IPAM-it, që përcakton nëse BERZH-i ka vepruar në pajtueshmëri me Politikën Mjedisore dhe Sociale ose me dispozitat specifike për projektin të Politikës së Aksesit në Informacion, në kuadër të një Projekti të caktuar
BERZH (ose Banka)	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
PMS	Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it në fuqi në kohën e miratimit të Projektit
IPAM	Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin i BERZH-it, i krijuar në përputhje me Politikën e Llogaridhënies për Projektin 2019
Kreu i IPAM-it	drejtori menaxhues i BERZH-it, përgjegjës për funksionimin e IPAM-it, zbatimin e Politikës së Llogaridhënies për Projektin dhe marrjen e vendimeve që janë në kompetencën e IPAM-it sipas kësaj Politike
PLIP	Politika e Llogaridhënies për Projektin 2019
Palët	individët, entitetet dhe/ose organizatat që kanë interes të drejtpërdrejtë në një Rast. Palët mund të përfshijnë (por nuk kufizohen te): Kërkuesit; Përfaqësuesit e tyre, nëse kanë; departamentin, ekipin ose njësinë përkatëse të Bankës; Klientin; dhe financuesit e Projektit ose entitetet e tjera që janë përgjegjëse për zbatimin e një Projekti
Zgjidhja e Problemit	funksion i IPAM-it, që mbështet zgjidhjen vullnetare të mosmarrëveshjeve midis Kërkuesve dhe Klientëve, për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe ato që lidhen me dhënien publike të informacionit, të parashtruara në një Kërkese, pa fajësuar askënd.
DPP	Dokumenti Përmbledhës i Projektit
Presidenti	Presidenti i BERZH-it

Përmbledhje Ekzekutive

Në datën 15 dhjetor 2022, [Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin](#) (IPAM) mori një [Kërkesë](#) nga Z. Ditmir Zeqa, përfaqësues i 60 individëve (Kërkuessit) banues në komunitetin e Bërçullës, Bashkia Vorë, Shqipëri. Kërkesa kishte të bënte me [Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466), të financuar nga BERZH-i. Kërkuessit pretendonin se do të humbnin aksesin te bizneset dhe banesat e tyre, si dhe te kisha e zonës për shkak se kalimi në nivel i hekurudhës, që përdorin aktualisht, do të mbyllej duke qenë se korridori i hekurudhës do të rrethohej. Megjithatë janë në dijeni se Projekti ka marrë parasysh krijimin e një kalimi automjetesh disa kilometra më tej, ata e konsiderojnë këtë kalim shumë larg për këmbësorët dhe u shprehën se rrugët lidhëse janë të papërshtatshme për automjetet e tonazhit të rëndë. Kërkuessit iu drejtuan Zgjidhjes së Problemit për trajtimin e shqetësimeve të tyre.

Më 26 korrik 2023, IPAM-i mbajti një takim të përbashkët me Palët në Bërçullë, gjatë të cilit u nënshkrua Marrëveshja për Zgjidhjen e Problemit. Rasti më pas kaloi te faza e Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit, aty ku IPAM-i mbikëqyr zbatimin e marrëveshjeve dhe raporteve në progres çdo gjashtë muaj. Raporti i parë i monitorimit u publikua në shkurt të vitit 2024 dhe i dyti në shtator të vitit 2024, dhe janë të disponueshëm në regjistrin virtual të rasteve te [Rasti 2023/02](#).

Gjatë periudhës së tretë të monitorimit (gusht 2024 - janar 2025), IPAM-i u angazhua me Palët për të dëgjuar pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre, dhe rishikoi dokumentacionin e ndarë nga Palët. IPAM-i i informon Kërkuessit për statusin e zbatimit të Marrëveshjes nëpërmjet takimeve virtuale; po ashtu, u përgatit një broshurë informuese, e cila iu shpërnda anëtarëve të komunitetit, duke i njoftuar për progresin e shënuar dhe duke u shpjeguar vonesat dhe hapat e radhës në proces.

Gjatë kësaj periudhe, pranë xhamisë është ndërtuar një nënkalim i ri për automjetet e vogla dhe këmbësorët, i cili aktualisht është plotësisht funksional. Gjithashtu, rruga ndihmëse për mjetet e rënda është në proces ndërtimi dhe pritet të asfaltohet në periudhën pranverë-verë, në varësi të kushteve atmosferike. Njëkohësisht, kalimi aktual në nivel pranë xhamisë mbetet i hapur derisa rruga ndihmëse të jetë plotësisht funksionale.

Disa toka duhej të shpronësoheshin për ndërtimin e rrugës ndihmëse, proces që u krye nga Hekurudha Shqiptare në përputhje me kërkesat e BERZH-it. Kjo pasohet me vendimin për shpronësimin që do të jepet nga Këshilli i Ministrave në muajt pasardhës. Pas kësaj, pronarët e prekur do të kompensohen sipas rastit.

Hekurudha Shqiptare e siguroi IPAM-in se nënkalimi ekzistues pranë hotelit të zonës do të vazhdojë të jetë funksional për automjetet e vogla dhe këmbësorët. IPAM-i vlerëson fleksibilitetin e Palëve dhe gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në kuadër të zbatimit të zgjidhjes dhe dëshiron t'i falënderojë të gjithë për qasjen e tyre bashkëpunuese.

Ky raport qarkulloi midis Palëve për komente përpara publikimit dhe u dorëzua për informacion te Bordi Drejtues i BERZH-it dhe presidenti. Ky raport do të bëhet i disponueshëm publikisht në dosjen virtuale të rasteve te [Rasti 2023/02](#) në gjuhën angleze dhe shqipe.

IPAM-i do të vijojë të monitorojë zbatimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit deri në përmbushjen e plotë të të gjitha angazhimeve të ndërmarra nga Palët. Raporti i katërt i Monitorimit për Zgjidhjen e Problemit do të mbulojë periudhën shkurt - korrik 2025 dhe pritet të publikohet në gusht të vitit 2025.

1. SFONDI

1.1. KËRKESA


Në datën 15 dhjetor 2022, [Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin](#) (IPAM) mori një [Kërkesë](#) nga Z. Ditmir Zeqa, përfaqësues i 60 individëve (Kërkuesit) banues në komunitetin e Bërxullës në Bashkinë Vorë, Shqipëri. Kërkesa kishte të bënte me [Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466), të financuar nga BERZH-i. Kërkuesit pretendonin se do të humbnin aksesin te bizneset dhe banesat e tyre, si dhe te kisha e zonës për shkak se kalimi në nivel i hekurudhës, që përdorin aktualisht, do të mbyllej duke qenë se korridori i hekurudhës do të rrethohej. Megjithëse janë në dijeni se Projekti ka marrë parasysh krijimin e një kalimi automjetesh disa kilometra më tej, ata e konsiderojnë këtë kalim shumë larg për këmbësorët dhe u shprehën se rrugët lidhëse janë të papërshtatshme për automjetet e tonazhit të rëndë. Kërkuesit iu drejtuan Zgjidhjes së Problemit për trajtimin e shqetësimeve të tyre.

1.2. PROJEKTI

[Projekti i Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466) është një hua sovrane në vlerën 36.87 milionë euro për Republikën e Shqipërisë dhe zbatohet nga Hekurudha Shqiptare. Projekti synon rehabilitimin e linjës hekurudhore ekzistuese me gjatësi 34.17 km ndërmjet qytetit të Tiranës dhe Durrësit, dhe ndërtimin e një segmenti hekurudhor të ri prej thuajse 5 km për të lidhur linjën hekurudhore ekzistuese Tiranë-Durrës me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe njëjën me linjën ekzistuese.

Projekti u miratua nga Bordi i BERZH-it më 30 nëntor 2016 dhe u klasifikua si i kategorisë B në kuadër të Politikës Mjedisore dhe Sociale 2014 të Bankës. Sipas [Dokumentit Përmbledhës të Projektit](#), Projekti do të përfshijë çështje mjedisore dhe sociale konkrete, kryesisht për shkak të rrethimit të korridorit hekurudhor dhe mbylljes së disa kalimeve të përdorura aktualisht nga komunitetet përgjatë hekurudhës.

Linja hekurudhore Tiranë-Durrës që do të rehabilitohet (vija e kuqe), lidhja e re me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (vija blu)



Burimi: Kuadri i Blerjes së Tokës për Projektin e Hekurudhës Shqiptare

2. NISMA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

[Nisma për Zgjidhjen e Problemit](#) u ndërmor nga IPAM-i në korrik të 2023-shit dhe fokusohej te sigurimi se zgjidhja teknike e propozuar nga Klienti do të trajtojë nevojat e Kërkuesve lidhur me aksesin e këmbësorëve dhe automjeteve, që do të zëvendësojë kalimin në nivel që komuniteti përdor aktualisht. Gjithashtu, Kërkuesit kanë kërkuar t'u garantohet se kalimi aktual në nivel do të qëndrojë i hapur deri në vendosjen në funksion të zgjidhjes teknike. Nga ana tjetër, Klienti i ka kërkuar komunitetit që të lejojë vijimin e punimeve ndërtimore të hekurudhës.

Më 26 korrik 2023, IPAM-i mbajti një takim të përbashkët me Palët në Bërxullë, ku Klienti u paraqiti Kërkuesve zgjidhjen teknike dhe e përshtati atë në përputhje me komentet e tyre. Gjithashtu, Palët ranë dakord që të silleshin me respekt gjatë periudhës së zbatimit. Gjatë takimit, Palët nënshkruan

Marrëveshjen për Zgjidhjen e Problemit, që do të mbahet konfidenciale sipas kërkesës së Palëve. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, Rasti 2023/02 kaloi te faza e Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit që IPAM-i të monitoronte zbatimin e tij.

3. MONITORIMI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT

Sipas pikës 2.5 a) të Politikës së Llogaridhënies për Projektin, IPAM-i do të monitorojë zbatimin e marrëveshjeve të dakorduara mes Palëve nëpërmjet Zgjidhjes së Problemit dhe do të caktojë përfundimin e tyre kur të përmbushen kriteret e mëposhtme:

- i. Në këto marrëveshje po zbatohen me efikasitet angazhimet e ndërmarra nga Palët; dhe
- ii. Po respektohen afatet e përcaktuara.

Lidhur me qasjen e monitorimit, Politika e Llogaridhënies për Projektin specifikon se në veprimtaritë e monitorimit, IPAM-i do të:

- konsultohet me Kërkuesit, Klientin, nivelin drejtues të Bankës dhe palët e tjera përkatëse të interesit.
- marrë parasysh dokumentacionin e Projektit, dokumentacionin e dorëzuar nga Kërkuesit (ose Përfaqësuesit e tyre nëse ka) apo Klienti dhe informacionin e disponueshëm publikisht.
- bëjë vizita në terren që lidhen me fushën e Projektit, nëse shihet e arsyeshme nga IPAM-i; dhe
- angazhojë konsulentët për çështje specifike teknike, nëse shihet e arsyeshme nga IPAM-i.



IPAM-i do të publikojë Raporte Monitorimi dy herë në vit për të përshkruar veprimtaritë e vazhdueshme të monitorimit dhe për të ofruar përditësime për statusin e zbatimit të çdo Marrëveshje për Zgjidhjen e Problemeve, derisa IPAM-i të përcaktojë zbatimin e plotë që është arritur.

3.1. VEPRIMTARITË E MONITORIMIT

Ky dokument është Raporti i tretë i Monitorimit, që mbulon periudhën nga muaji gusht 2024 në janar 2025. Gjatë periudhës së monitorimit, IPAM-i ndërmori veprimtaritë e mëposhtme:

- Angazhimin me Partitë nëpërmjet takimeve virtuale dhe email-eve për të kërkuar informacione për progresin e zbatimit të Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit: (takim me Kërkuesit më 24 tetor 2024; takim me Klientin më 1 gusht 2024 dhe 14 tetor 2024; përditësime me shkrim nga Klienti gjatë gushtit 2024 dhe dhjetorit 2024, dhe përditësime për Kërkuesit në gusht 2024 dhe dhjetor 2024).
- Rishikimin e dokumenteve; dhe
- Broshurën informuese për Kërkuesit për t'i përditësuar ata lidhur me progresin dhe vonesat në zbatim, e cila u shpërnda në janar të vitit 2025.

Fotografi të rrugës ndihmëse në ndërtim në Berxullë, dhjetor 2024. Burimi: Hekurudha Shqiptare



Fotografi e pronës që i nënshtrohet shpronësimit në Bërxullë, dhjetor 2024. Burimi: Hekurudha Shqiptare



3.2. STATUSI I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Gjatë kësaj periudhe, pranë xhamisë është ndërtuar një nënkalim i ri për automjetet e vogla dhe këmbësorët, i cili aktualisht është plotësisht funksional. Gjithashtu, rruga ndihmëse për mjetet e rënda është në proces ndërtimi dhe pritet të asfaltohet në periudhën pranverë-verë, në varësi të kushteve atmosferike. Njëkohësisht, sipas angazhimit të Klientit, kalimi aktual në nivel pranë xhamisë mbetet i hapur derisa rruga ndihmëse të jetë plotësisht funksionale.

Për ndërtimin e rrugës ndihmëse duhet të shpronësohen disa toka private. Klienti ka komunikuar me dy pronarë toke të prekur, të cilët ranë dakord të lejonin që një pjesë e tokës së tyre të shpronësohej për ndërtimin e rrugës ndihmëse. Procesi i shpronësimit po udhëhiqet nga Hekurudha Shqiptare me mbështetjen e Bashkisë Vore, në përputhje me kërkesat e BERZH-it. Ky proces përfshin një sërë hapash administrative, të nevojshëm për të përmbushur kërkesat kombëtare dhe standardet mjedisore dhe sociale të BERZH-it. Pritet që vendimi për shpronësimin të jepet nga Këshilli i Ministrave. Hekurudha Shqiptare shpjegoi se me lëshimin e vendimit, dy pronarët e prekur do të kompensohen për ndikimet e Projektit.

Hekurudha Shqiptare e siguroi IPAM-in se nënkalimi ekzistues pranë hotelit të zonës do të vazhdojë të jetë funksional për automjetet e vogla dhe këmbësorët me vënien në funksion të hekurudhës.

IPAM-i i informoi Kërkuesit për statusin e zbatimit të Marrëveshjes nëpërmjet angazhimit virtual. Po ashtu, u përgatit edhe një broshurë e tretë informuese, e cila iu shpërnda anëtarëve të komunitetit në janar të vitit 2025, duke i njoftuar ata për progresin e shënuar dhe duke u shpjeguar vonesat dhe hapat e radhës në proces. Komunitetit iu shpërndanë kopje të fletushkës falë ndihmës së Përfaqësuesit të Kërkuesve.

Komuniteti i Bërxullës ishte falënderues për informacionin e ofruar dhe u tregua mirëkuptues për nevojën për të ndjekur procesin e rregullt, si dhe është angazhuar për t'u përfshirë me Hekurudhën Shqiptare dhe Kontraktorin e saj për shmangjen e konflikteve në të ardhmen ndërmjet banorëve të zonës.

Pavarësisht disa vonesave dhe sfidave të hasura, Klienti synon të përfundojë të gjitha veprimet e dakorduara deri në verë. IPAM-i vlerëson fleksibilitetin e Palëve dhe gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në kuadër të zbatimit të zgjidhjes dhe dëshiron t'i falënderojë të gjithë për qasjen e tyre bashkëpunuese.

4. PËRFUNDIMI

Gjatë periudhës së katërt të monitorimit (gusht 2024 - janar 2025), pranë xhamisë është ndërtuar një nënkalim i ri për automjetet e vogla dhe këmbësorët, i cili është plotësisht funksional. Gjithashtu, rruga ndihmëse për mjetet e rënda është në proces ndërtimi dhe pritet të asfaltohet në periudhën pranverë-verë, në varësi të kushteve atmosferike. Njëkohësisht, kalimi aktual në nivel pranë xhamisë mbetet i hapur derisa rruga ndihmëse të jetë plotësisht funksionale.

Disa toka duhej të shpronësoheshin për ndërtimin e rrugës ndihmëse, proces që u krye nga Hekurudha Shqiptare në përputhje me kërkesat e BERZH-it. Kjo pasohet me vendimin për shpronësimin që do të jepet nga Këshilli i Ministrave në muajt pasardhës. Pas kësaj, pronarët e prekur do të kompensohen sipas rastit. Pavarësisht disa vonesave dhe sfidave të hasura, Klienti synon të përfundojë të gjitha veprimet e dakorduara deri në verë.

Ky raport do të publikohet në regjistrin e rasteve të IPAM-it, në dosjen e faqes së internetit me emërtim [Rasti 2023/02](#) në gjuhën angleze dhe shqipe pas dorëzimit për informacion te Bordi Drejtues i BERZH-it dhe presidenti. Raporti i katërt i Monitorimit për Zgjidhjen e Problemit do të mbulojë periudhën shkurt - korrik 2025 dhe pritet të publikohet në gusht të vitit 2025.